

SHOQËRISË “EGI-K” SHPK

BULQIZË

NUIS K77424401L

**RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR
PËR ZVOGËLIM KAPITALI**

AUDITUESI LIGJOR BUJAR RAMI

**LIÇENSA NR.90. DT 10.01.2001, NIPTI L21501047E ADRESA
RR.”PETRO NINI LUARASI ” TIRANË,E-MAIL
bujar.rami@live.com Cel.0686064118.**

TIRANË,MË 27 DHJETOR 2023



**ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË “EGI-K ”SHPK BULQIZË
SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR
PËR ZVOGËLIM KAPITALI TË SHOQËRISË
“EGI-K ”SHPK BULQIZË**

I nderuar zoti Eduart!

Me cilësinë e Audituesit Ligjor i emëruar nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë “**EGI-K**” SHPK Bulqizë ,me vendimin NR 12 datë 20/12/2023, për hartimin e raportit mbi për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë “**EGI-K** ”SHPK Bulqizë , si dhe në zbatim të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 , “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “ (I ndryshuar) Neni 68,pika 5,6, Neni 112,,135,136,Neni 145,pika 1,Neni 181,182,184 dhe Neni 185, ju paraqes raportin tim sa më poshtë vijon :

Disa të dhëna lidhur me Shoqërinë:

Shoqëria “**EGI-K** ”SHPK Bulqizë , me NIPT **K77424401L** është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me kapital **646,123,000** (gjashtëqintë e dyzetë e gjashtë milion e njëqindë e njëzetë e tre mijë) lekë , me ortakë të vetëm **z.Eduart Keta** , I cili zotëron **100%** të kapitalit.

Administrator i shoqërisë është **z. Eduart Keta** .

Selia e Shoqërisë është në Bulqizë.

Objekti kryesor i aktivitetit të kësaj shoqërie është në fushën e kromeve i përshkruar qartë sipas regjistrit tregtar te QKB-së

Në zbatim të misionit të ngarkuar nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë me vendimin e cituar më lartë , u shqyrtuan dhe u kryen verifikimet e nevojshme konformë rregullave të profesionit dhe dispozitave ligjore ne fuqi.

Sipas vendimit të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë Nr. 12 datë 20/12/2023 është vendosur zvogëlimi i kapitalit në masën **93,661,150** (nëntëdhjetë e tremilion e gjashtëqindë e gjashtëdhjetë e njëmijë e njëqindë e pesëdhjetë)lekë , si edhe dhe zvogëlimi i vlerës së pjesës po në vlerën **93,661,150** lekë.

Gjithsej zvogëlimi i i kapitalit do të jetë 93,661,150 lekë.

Zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë EGI-K shpk do të bëhet nëpërmjet transferimit të aktiveve të shoqërisë te Subjektet KETA CHROME SHPK dhe KETA MINE SHPK në vlerat si më poshtë vijon:

1-Zvogëlimi i Kapitalit të shoqërisë EGI-K shpk nëpërmjet marrëveshjes së transferimit të aktivitetit Nr.3878 REP dhe Nr. 1418 KOL, datë 06.12.2023 dhe faturës tatimore nr. 164/2023 datë 27/12/2023 të transferimit te kontribudeve në natyrë në masën **36,880,690** (tridhjetë e gjashtë milion e tetëqindë e tetëdhjetë mijë e gjashtëqindë e nëntëdhjetë) lekë, vlerë e të cilave do të shkojë në zmadhimin e kapitalit i cili te Shoqeria KETA CHROME shpk Bulqizë.



2- Zvogëlimi i Kapitalit të shoqërisë EGI-K shpk sipas marrëveshjes së transferimit të aktivitetit Nr.3879 REP dhe Nr 1419 KOL, datë 06.12.2023,dhe faturës tatimore nr. 165/2023 datë 27/12/2023 të transferimit të kontribudeve në natyrë në masën **56,780,460**(pesëdhjetë e gjashtëmilion e shtatëqindë e tetëdhjetëmijë e katërqindë e gjashtëdhjetë) vlerë e të cilave do të shkojë në zmadhimin e kapitalit i cili të Shoqëria KETA MINE shpk Bulqizë.

Duke ju referuar të dhënave përkatëse sipas dokumentave të sipërmendur ,vlerësimi i kontribudeve në natyrë me anën është bërë zvogëlimi i kapitalit në këtë shoqëri,është bërë bazuar në vlerën neto të realizuar dhe këto kontribute në natyrë rezultojnë si më poshtë vijon:

Aktive afat gjata materiale.....90,139,124 lekë
Inventar ekonomik3,522,026 lekë
TOTALI93,661,150 lekë

Nga testet dhe verifikimet përkatëse që kam bërë rezulton se asetet e kontribudeve në natyrë “Aktiveve Afatgjata Materiale”dhe Inventar Ekonomik , në vlerën **93,661,150** lekë , me të cilat do të bëhet ky zvogëlim kapitali janë evidentuar saktësisht dhe pasqyruar në mënyrë korrekte në Kontabilitet e Shoqërisë dhe në Pasqyrat financiare të vitit 2022 që disponon kjo shoqëria EGI-K SHPK Bulqizë. Për vlerësimin e zvogëlimin të kapitalit jam mbështetur në dokumentat e përshkruara si më sipër. Veprimet e nevojshme janë evidentuar dhe bërë saktësisht në llogarië përkatëse sipas vlerës respektive me anën e të cilës do të ky zvogëlm kapitali. Për hartimin e Raportit të zvogëlimin të kapitalit jam mbështetur edhe në dokumenta të tjera të vëna në dispozicion nga ana e shoqërisë sic janë :Inventarët e pasurisë,analizat e llogarive,ekstraktet e regjistrit tregtar....etj.

Si përfundim :

A -Kapitali i shoqërisë “EGI-K”SHPK Bulqizë ,pas këtij zvogëlimi do të jetë si më poshtë vijon :

	ISHTE	BËHET-
Kapitali i regjistruar	646,123.000 lekë	552,461,850 lekë

B- Kuota e zotëruara ,përqindja e pjesëmarrjes në Kapital dhe kontribudi në kapitalin e Shoqërisë “EGI-K”SHPK Bulqizë i Ortakut të Vetëm ,pas këtij zvogëlimi do të jenë si më poshtë vijon :



2-Për Ortakun Individ ,z. Eduart Keta ,

	ISHTE	BËHET
-Pjesët e zotëruara	1(pjesë)	1(pjesë)
- Pjesëmarrja në përqindje(%)	100(%)	100 (%)
-Kontribudi në kapital	646,123.000 lekë	552,461,850 lekë .

Theksojmë këtu se pas këtij zvogëlim kapitali pjesëmarrja në përqindje dhe numri i pjesëve në kapital nuk kanë ndryshuar por ka ndryshuar kontribudi në kapitalin si dhe vlera e pjesës në këtë shoqëri.

Në zbatim të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Per Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare” (I ndryshuar) Neni 68,pika 5,6, Neni 112,,135,136,Neni 145,pika 1,Neni 181,182,184 dhe Neni 185, për zvogëlimin e kapitalit , si dhe të vendimit përkatës të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë “**EGI-K**”SHPK Bulqizë , si dhe pas testimave përkatëse që ne kemi bërë theksojmë se shuma prej **552,461,850** (pesëqintë e pesëdhjetë e dy milion e katër qindë e gjashtëdhjetë e njëmijë e tetëqintë e pesëdhjetë)lekë , është e argumentuar dhe e sistemuar sipas rregullave të mbajtjes së kontabilitetit financiar duke u paraqitur në postet e duhura të bilancit të reformuar të kësaj shoqërie .

Llogaritë që do të preken, si rezultat i zvogëlimi të kapitalit si më sipër janë : llogaria 101, llogaria 212,,215 dhe llog 213.

Operacioni i zvogëlimi të kapitalit të shoqërisë “**EGI-K**”SHPK Bulqizë , i propozuar dhe i miratuar nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë , është i motivuar nga legjislacioni në fuqi dhe i justifikuar financiarisht.

Pas shqyrtimit të sipërpërmendur të dokumentave financiare e kontabël, kapitali i përcaktuar prej **552,461,850** (pesëqintë e pesëdhjetë e dy milion e katër qindë e gjashtëdhjetë e njëmijë e tetëqintë e pesëdhjetë) lekë i përgjigjet vlerës së aktivitetit neto të shoqërisë.

Ky raport zvogëlim kapitali përgaditet në dy kopje,ku njëra kopje I dorëzohet Shoqërisë dhe një kopje depozitohet në dosjen e punë përkatëse të Audituesit Ligjor.

AUDITUESI LIGJOR

BUJAR RAMI



Tiranë më 27/12/2023



“EGI-K” shpk, Bulqize

NIPT K77424401L

Bulqizë me datë 20/12/2023

VENDIM

NR 12, DATË 20/12/2023

I ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË EGI-K SHPK

Sot me datë 20/12/2023, në Selinë e Shoqërisë “EGI-K “ SH.P.K Bulqizë, u zhvillua mbledhja e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë, për emërimin e Audituesit Ligjor,për përgatitjen e raportit për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë,nëpërmjet pakësimit të kontribudeve në natyre,në formën e transferimit të një tërësie të pjesshme të aktivitetit,sipas kontratës përkatëse të transferimit të aktivitetit Nr.3878 REP dhe Nr.1418 KOL, datë 06.12.2023 dhe sipas kontratës përkatëse të transferimit të aktivitetit Nr.3879 REP dhe Nr. 1419 KOL, datë 06.12.2023 dhe duke u bazuar ne Ligjin Nr.9901,date 14.04.2008 “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, (i ndryshuar) dhe te Statutit te shoqerise “EGI-K” SH.P.K,Ortaku i Vetem,

V E N D O S I :

1.Emërimin e z. **Bujar Rami** , anëtar i IEKA-së , me profesion Auditues Ligjor me liçense Nr. 90, datë 10/01/2001 , për vlerësimin e zvogëlimit të kapitalit të shoqërisë,nëpërmjet pakësimit të kontribudeve në natyrë,në formën e transferimit të një tërësie të pjesshme të aktivitetit,spas kontratave të transferimit, të sipërcituar më sipër.

2.Depozitimi i ketij vendimi ne Qendren Kombetare te Biznesit

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

(Eduart Keta)

